

SONY®

Sistem kinemaje në shtëpi me DVD/Blu-ray Disc™

BDV-N5200W

AL Fillo këtu

Udhëzuesi i fillimit të shpejtë



BDV-N5200W

1

Çfarë ka në kuti/Konfigurimi i altoparlantëve

2

Lidhja e televizorit

3

Lidhja me pajisje të tjera

4

Konfigurimi i lehtë në ekran

5

Riprodhimi dhe përdorimi i funksioneve të tjera


BDV-N5200W



- A Njësia kryesore
- B Altoparlantët e përparmë
- C Altoparlantët rrethues
- D Altoparlanti qendror
- E Nën-vuferi
- F Amplifikuesi rrethues

Çfarë ka në kuti

Telekomanda



Bateri R03 (madhësia AAA) (2)





Antena FM me tel (ajrore)



1



Nisni duke pozicionuar altoparantët sipas etiketave në panelin e pasmë **A**.

Gjithashtu mund të vendosni altoparantët në pozicionin [All Front] (Të gjithë përpara) **B**.
Për detaje të mëtejshme, vizitoni:
<http://support.sony-europe.com/>



Më pas, lidhni altoparantët me njësinë kryesore dhe amplifikuesin rrethues.

Për montimin e altoparantëve, referohuni te „Udhëzuesi i instalimit të altoparantëve“.




2


Për të shijuar video dhe audio me cilësi të lartë, lidhni përmes një kabloje HDMI me shpejtësi të lartë **A** (nuk jepet) dhe një kordon dixhital optik **B** (nuk jepet).

Megjithatë, nëse televizori juaj ka fole HDMI ARC (Audio Return Channel), nuk ju nevojitet një kordon dixhital optik **B** (nuk jepet).

Lidhja e televizorit pa fole HDMI ARC



Lidhja e televizorit me fole HDMI ARC



3

Për të lidhur dekoderin, konsolën e videoljërave ose marrësin dixhital satelitor, thjesht lidhni nëpërmjet kabllot HDMI **A** (nuk jepet).

Për radio FM, lidhni antenën e dhënë me tel (ajrore) **B** dhe shtrijeni atë për marrjen më të mirë.



3


Mund të lidheni me internetin dhe rrjetin e shtëpisë përmes një LAN-i me valë ose kabloje LAN **A** (nuk jepet).

Cilësimet e rrjetit mund të gjenden në menynë kryesore (faqe 13).
Për detaje të mëtejshme, vizitoni: <http://support.sony-europe.com/>

Lidhni kordonët elektrikë (dalja e korrentit) **B** të njësisë kryesore dhe të amplifikuesit rrethues në prizë (sistemi elektrik).



Me një ruter me brez të gjerë




4

Shtypni I/⏻ për të ndezur sistemin. Në ekranin e panelit të sipërm shfaqet „SETUP“.

Për të përgatitur sistemin për përdorim, kryeni cilësimet e lehta fillestare në ekran duke përdorur telekomandën e dhënë. Kjo kërkon vetëm pak minuta. Nëse ekrani i konfigurimit nuk shfaqet, zgjidhni hyrjen e duhur AV në televizor.

Pasi në ekran të shfaqet [Easy Initial Settings are complete.] (Cilësimet e lehta fillestare u kryen), zgjidhni [Finish] (Përfundo) dhe sistemi është gati për përdorim.



5

Për të luajtur një disk, shtypni ▲ për të hapur kapakun e diskut, vendosni diskun (me etiketën me drejtim lart) në bosht dhe më pas shtypni ▲ për të mbyllur kapakun e diskut.

Nëse riprodhimi nuk fillon automatikisht, zgjidhni ● në kategorinë [Video], [Music] (Muzikë), ose [Photo] (Foto) dhe shtypni [+].




Ju mund të shijoni muzikë në telefonin tuaj smartphone, etj., përmes komunikimit BLUETOOTH nga sistemi juaj.

Ju mund të çiftoni/lidhni pajisjen tuaj BLUETOOTH me një prej këtyre:

- A duke shtypur butonin BLUETOOTH, ose
- B duke e mbajtur pajisjen pranë shenjës N në njësinë kryesore (vetëm për pajisje të përputhshme me NFC).


Në çdo rast, kërkohet gjithashtu edhe veprimi në pajisjen tuaj. Për detaje të mëtejshme, vizitoni: <http://support.sony-europe.com/>



Për të pasur akses në më shumë veçori, thjesht shtypni HOME.

Shembuj:

- A** Dëgjimi i radios përmes altoparlantëve të sistemit
- B** Paravendosja e stacioneve të radios
- C** Aksesimi në përmbajtjen nga interneti
- D** Luajtja e skedarëve në pajisjen USB të lidhur




Paravendosja e stacioneve të radios

- 1 Shtypni FUNCTION vazhdimisht derisa të shfaqet "FM" në ekranin e panelit të sipërm.
- 2 Shtypni dhe mbani shtypur TUNING +/- derisa të nisë skanimi automatik.
- 3 Shtypni OPTIONS.
- 4 Shtypni $\blacktriangle/\blacktriangledown$ për të zgjedhur [Preset Memory] (Memoria e paravendosur), më pas shtypni \boxplus .
- 5 Shtypni $\blacktriangle/\blacktriangledown$ për të zgjedhur numrin e paravendosjes që dëshironi, më pas shtypni \boxplus .
- 6 Përsëritni hapat 2 deri 5 për të ruajtur stacionet e tjera.

Zgjedhja e një stacioni të paravendosur

- 1 Shtypni FUNCTION vazhdimisht derisa të shfaqet "FM" në ekranin e panelit të sipërm.
- 2 Shtypni PRESET +/- në mënyrë të përsëritur për të zgjedhur stacionin e paravendosur.



Zgjidhja e problemeve

Nëse ju ndodh një nga vështirësitë e mëposhtme gjatë përdorimit të sistemit, përdorni këtë udhëzues për zgjidhjen e problemeve për t'ju ndihmuar të zgjidhni problemin përpara se të kërkon riparime.

Gjithashtu referojuni udhëzimeve të përdorimit në faqen e mëposhtme:

<http://support.sony-europe.com/>

Energjia nuk ndizet.

→ Kontrolloni që kordoni i rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) të jetë lidhur mirë me prizën e murit (rrjeti).

Sistemi nuk punon normalisht.

→ Shkëputni kordonin e rrymës së drejtpërdrejtë (rrjetit elektrik) nga priza e murit (rrjeti), më pas rilidheni pas disa minutash.

Sistemi nuk e nxjerr zërin e programeve televizive kur lidhet me një dekoder.

→ Kontrolloni lidhjet.

→ Zgjidhni daljen e saktë të sistemit me të cilën është lidhur dekoderi.

Nuk ka zë ose transmetimi me valë nuk është aktivizuar.

→ Kontrolloni gjendjen e treguesit LINK/STANDBY në amplifikuesin rrethues.

- Fiket.
 - Kontrolloni që kordoni elektrik (dalja e korrentit) i amplifikuesit rrethues të jetë lidhur në mënyrë të sigurt.
 - Ndizeni amplifikuesin rrethues duke shtypur I/⏻ në amplifikatorin rrethues.

- Pulson në të kuqe.
 - Shtypni I/⏻ për të fikur amplifikuesin rrethues dhe kontrolloni si më poshtë.
 - ① Mos bëjnë qark të shkurtër kordonët e + dhe – të altoparlantëve?
 - ② Ka ndonjë gjë që pengon hapësirën e ajrimit të amplifikuesit rrethues?
 - Pasi të kontrolloni sa më lart dhe të ndreqni problemet e mundshme, ndizni amplifikuesin rrethues. Nëse shkak i problemit nuk mund të gjendet edhe pas kontrollit të mësipërm, kontaktoni me shitësin më të afërt të Sony.
- Pulson me ngadalë në të gjelbër ose portokalli, ose bëhet e kuqe.
 - Transmetimi i zërit është i dobët. Lëvizeni amplifikuesin rrethues në mënyrë që treguesi LINK/STANDBY të bëhet i gjelbër ose portokalli.
 - Lëvizeni sistemin larg pajisjeve të tjera me valë.
 - Shmangni përdorimin e pajisjeve të tjera me valë.
- Bëhet i gjelbër ose portokalli.
 - Kontrolloni lidhjet e altoparlantëve.

Një nga altoparlantët rrethues nuk lëshon zë.

→ Shtypni OPTIONS dhe kontrolloni që [Sound Field] (Fusha zanore) të jetë vendosur në [ClearAuto+] (Pastro audion +).

Disku nuk luhet.

→ Kodi rajonal i diskut nuk përputhet me sistemin.

→ Mbi lentet brenda njësisë kryesore është kondensuar lagështirë. Hiqni diskut dhe lëreni njësinë kryesore të ndezur për rreth gjysmë ore.

→ Disku nuk është finalizuar saktë.

Reduktimi i përdorimit të energjisë në më pak se 0,3 W gjatë modalitetit të gatishmërisë

Shtypni HOME dhe më pas shtypni ⚡/⚡/⚡ për të zgjedhur [Setup] (Konfigurimi). Kontrolloni që të jenë zgjedhur cilësimet e mëposhtme:

- Zgjidhni [System Settings] (Cilësimet e sistemit) > [HDMI Settings] (Cilësimet e HDMI) > [Control for HDMI] (Kontrolli për HDMI), më pas vendoseni [Control for HDMI] (Kontrolli për HDMI) në [Off] (Fikur).
- Zgjidhni [System Settings] (Cilësimet e sistemit) > [Quick Start Mode] (Modaliteti i ndezjes së shpejtë), më pas vendoseni [Quick Start Mode] (Modaliteti i ndezjes së shpejtë) në [Off] (Joaktiv).
- Zgjidhni [System Settings] (Cilësimet e sistemit) > [NFC], më pas vendoseni [NFC] në [Off] (Joaktiv).
- Zgjidhni [Network Settings] (Cilësimet e rrjetit) > [Remote Start] (Ndezja në distancë), më pas vendoseni [Remote Start] (Ndezja në distancë) në [Off] (Joaktiv).



Një aplikacion i dedikuar për këtë model është i disponueshëm si në Google Play, ashtu edhe në App Store. Kërkoni „SongPal” dhe shkarkoni aplikacionin falas për të zbuluar më shumë rreth veçorive praktike.

Aplikacioni Easy Control, „SongPal”, mbështet funksionimin me valë. Ai ju lejon që:

- të zgjidhni përmbajtje muzikore/audio nga funksionet e integruara të telefonave smartphone dhe pajisjeve të ndryshme.
- të kontrolloni me intuitë cilësimet e ndryshme.
- të përmirësoni muzikën vizualisht me ekranin e telefonit tuaj smartphone.

Për të përdorur këtë funksion, sigurohuni që të kryeni përditësimin e softuerit.



Ky udhëzues i fillimit të shpejtë kursen letrën

Për të kursyer burimet natyrore, Sony ka reduktuar konsiderueshëm përdorimin e letrës duke mos përfshirë më manualë të printuar në letër. Megjithatë, udhëzimet e plota të përdorimit, dhe më shumë, mund të gjenden në internet:

<http://support.sony-europe.com/>

